

20110531485

L I G J
PËR PLOTESIMIN E LIGJIT PËR BUJQESI DHE
ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqesi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 49/10) në nenin (33) pas paragrafit 6 shtohen 20 paragrafe të rinj (7), (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19), (20), (21), (22), (23), (24), (25) dhe (26), si vijojne:

"(7) Ministria e Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave, në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkeses për leshimin e aktvendimit për regjistrim në regjistrin e grumbulluesve, miraton aktvendim, me të cilin vendos për kërkesen për leshimin e aktvendimit për regjistrim në regjistrin e grumbulluesve.

(8) Nëse Ministria e Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave nuk miraton aktvendim për regjistrim në regjistrin e grumbulluesve, perkatesisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkeses në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkeses ka të drejte që në afat prej tri diteve të punes nga kalimi i këtij afati, të parashtroje kerkese në sekretarine e ministrit të Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave, për miratimin e aktvendimit për kërkesen e parashtruar.

(9) Formen dhe permbajtjen e kërkeses nga paragrafi (7) i këtij neni, i percakton ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave.

(10) Me kërkesen për miratimin e aktvendimit për regjistrim në regjistrin e grumbulluesve, parashtruesi i kërkeses dorezon edhe kopje të kërkeses nga paragrafi (6) i këtij neni.

(11) Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave, detyrohet që, në afat prej pese diteve të punes nga dita e pranimit të kërkeses nga paragrafi (7) i këtij neni, në sekretarine e Ministrise së Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave, të miratoje aktvendim me të cilin kërkesa për leshimin e aktvendimit për regjistrim në regjistrin e grumbulluesve pranohet apo refuzohet. Nëse ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarine e selise së Ministrise.

(12) Nëse ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (9) i këtij neni, parashtruesi i kërkeses mund ta njoftoje Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pese diteve të punes.

(13) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjete ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (11) i këtij neni, të kryeje mbikeqyrje në Ministrine e Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer e informon parashtruesin e kërkeses.

(14) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikeqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin e Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave që në afat prej dhjete ditësh të vendose për kërkesen e parashtruar, perkatesisht ta pranoje apo refuzoje kërkesen dhe ta njoftoje inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorezohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesen e parashtruar.

(15) Nëse ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave nuk vendos në afatin nga paragrafi (13) i këtij neni, inspektori do të parashtroje kerkese për ngritjen e procedures kundervajtëse për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ dhe do të percaktojë afat plotësues prej pese diteve të punes, në të cilin ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave do të vendose për kërkesen e parashtruar, për çfare në atë afat do ta njoftoje inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorezohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesen e parashtruar. Inspektori në afat prej tri diteve të punes e informon parashtruesin e kërkeses për masat e ndermarra.

(16) Nese Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave nuk vendos edhe në afatin plotesues nga paragrafi (13) i ketij neni, inspektori në afat prej tri diteve të punes, do të parashtroje kallezim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

(17) Nese inspektori nuk vepron për njoftimin nga paragrafi (13) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses në afat prej pese diteve të punes ka të drejte që të parashtroje kundershtrim në sekretarinate e drejtorit të Inspektoratit Shteteror Administrativ. Nese drejtori nuk ka sekretari, kerkesa parashtrohet në sekretarinate e selise së Inspektoratit Shteteror Administrativ.

(18) Drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ detyrohet që në afat prej tri diteve të punes nga dita e pranimit ta shqyrtoje kundershtrimin nga paragrafi (16) i ketij neni, dhe nese konstaton se inspektori nuk ka vepruar për njoftimin e parashtruesit të kerkeses nga paragrafet (12) dhe (13) të ketij neni dhe/ose nuk parashtron kallezim në pajtim me paragrafet (14) dhe (15) të ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të parashtroje kerkesa për ngritjen e procedures kundervajtese për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin, dhe do të percaktoje afat plotesues prej pese diteve të punes, në të cilin inspektori do të kryeje mbikeqyrje në Ministrine e Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave nese eshte zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer, ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

(19) Nese inspektori nuk vepron edhe në afatin plotesues nga paragrafi (17) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të parashtroje kallezim te prokurori publik kompetent kunder inspektorit dhe në afat prej tri diteve të punes do ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

(20) Në rastin nga paragrafi (18) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ menjehere, e më së voni në afat prej një dite pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryeje mbikeqyrjen menjehere.

(21) Në rastet nga paragrafi (19) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ në afat prej tri diteve të punes, do ta informoje parashtruesin e kerkeses.

(22) Nese drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (17) të ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund të parashtroje kallezim te prokurori publik kompetent në afat prej tete diteve të punes.

(23) Nese Ministri i Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave nuk vendos në afatin nga paragrafi (15) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund të ngrite kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(24) Procedura në Gjykatën Administrative eshte urgjente.

(25) Akti nenligjor nga paragrafi (8) i ketij neni miratohet në afat prej 15 ditesh nga dita e miratimit të ketij ligji.

(26) Pas miratimit të aktit nenligjor, ai menjehere, e më së voni në afat prej 24 oresh publikohet në ueb faqen e Ministrise së Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave."

Paragrafet (7) dhe (8) shlyhen.

Paragrafi (9) behet paragraf (27).

Neni 2

Në nenet 121 paragrafi (2) dhe 128 paragrafi (6) fjalet: "Komisionin e shkalles së dyte të Qeverise së Republikës së Maqedonise, kompetent për zgjidhjen e ceshtjeve nga sfera e marredhenieve të punes" zevendesohen me fjalet: "Komisionin Shteteror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure për Marredhenie të Punes në Shkalle të Dyte.

Neni 3

Akti nenligjor i percaktuar në nenin 33 paragrafi (8) i ketij ligji, do të miratohet në afat prej 30 ditesh nga dita e hyrjes në fuqi e ketij ligji.

Neni 4

Dispozita nga neni 3 i ketij ligji, do të filloje të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure për Marredhenie të Punes në Shkalle të Dyte.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".